



Arkeu 3.8-2.5 miliardë vjet më parë

Planeti ynë gjatë Arkeut ndryshon kryekëput nga ky i sotmi. Atmosfera ishte mjaft e rrallë dhe përbëhej nga metani, amoniaku e gaze të tjera helmuese për pjesën më të madhe të organizmave që jetojnë sot. Ishte kjo koha kur në tokë pasi kishin kaluar të ashtuqujturat fazë e Hënës, e Marsit, dhe fillimet e saj, ishin krijuar kushtet e krijimit të pllakave kontinentale. Kjo kishte ndodhur si rezultat i ftohjes së mjaftueshme të tokës e cila krijoi mundësitë e formimit të shkëmbinjve të parë.

Ishte agimi i jetës në tokë. Fosilet tona më të vjetra datojnë 3.5 miliardë vjet më parë, dhe konsistojnë më mikrofosile bakteriesh. Në fakt, e gjithë jeta gjatë më shumë se një miliard vjetësh në Arke ishte bakteriale. Fosile të kësaj kohe janë stromatolitet, koloni bakteriesh fotosintetike që janë gjetur në Afrikën e Jugut dhe Australi. Stromatolitet u shtuan në shumicë gjatë Arkeut, por filluan të tatëpjetën gjatë proterozoit. Sot janë zhdukur.